



## SHËRBESA E MËNGJESIT

**Prifti:** *(me zë të lartë)* I bekuar është Perëndia ynë, gjithnjë, tani e përherë e në jetë të jetëve.

**Psaltët:** Amin.

**Lexuesi**

**(Anagnosti):** Shenjt Perëndi, Shenjt i fuqishëm, Shenjt i pavdekshëm, mëshirona *(tri herë)*.

Lavdi Atit e Birit edhe Shpirtit të Shenjtë, tani e përherë e në jetë të jetëve. Amin.

Trini e Tërëshenjtë, mëshirona; o Zot, falna mëkatet tona, o Zot i madh, ndjei paudhësitë tona; o i Shenjtë, vështro dhe shëro sëmundjet tona, për emrin tënd.

Mëshiro, o Zot *(3 herë)*.

Lavdi Atit e Birit edhe Shpirtit të Shenjtë, tani e përherë e në jetë të jetëve. Amin.

Ati ynë që je në qiejt, u shenjtëroftë emri yt, ardhhtë mbretëria jote, u bëftë dëshira jote si në qiell ashtu edhe mbi dhe. Bukën tonë të përditshme jepna neve sot; dhe falna fajet tona, sikurse edhe ne ua falim fajtorëve tanë; dhe mos na shtjer në ngasje, po shpëtona nga i ligu.

**Prifti:** Se jotja është mbretëria dhe fuqia dhe lavdia, e Atit, e Birit dhe e Shpirtit të Shenjtë, tani e përherë e në jetë të jetëve.

**Lexuesi**

**(Anagnosti):** Amin.

O Zot, shpëto popullin tënd dhe bekoje trashëgimin tënd.  
Dhuroju shpresëtarëve fitore mbi barbarët dhe ruaje shtetin tënd me anën e Kryqit tënd.

Lavdi Atit e Birit edhe Shpirtit të Shenjtë.

Ti që mbi Kryqin u mbërtheve me dashje, shtetit të ri që ka emrin tënd dhuroi dhembshuritë e tua, o Krisht Perëndi. Ngazëlloi me fuqinë tënde krerët tanë besnikë, duke u falur fitore kundër armiqve, paçin përkrahjen tënde, armë paqeje, trope të pamposhtur.

Tani e përherë e në jetë të jetëve.

O Hyjlindëse e mirë, e tërëhimnuar, mbrojtje e frikshme dhe e paturpëruar, mos i përbuz lutjet tona; mbështete shtetin e orthodhoksëve, shpëtoi ata që i urdhërove të mbretërojnë dhe dhuroju nga qiejt fitoren; se ti linde Perëndinë, o e vetmja e bekuar.

**Prifti:** Mëshirona, o Perëndi, si pas mëshirës sate të madhe, të lutemi, dëgjo dhe mëshiro.

**Psaltët:** Mëshiro, o Zot (*tri herë*).

**Prifti:** Lutemi dhe për të krishterët shpresëtarë dhe orthodhoksë.

**Psaltët:** Mëshiro, o Zot (*tri herë*).

**Prifti:** Lutemi edhe për Kryepiskopin tonë (*aksh*) [ose episkopin tonë (*aksh*)].

**Prifti:** Se Ti je Perëndi mëshirues dhe njeridashës dhe Ty ta drejtojmë lavdinë, Atit e Birit edhe Shpirtit të Shenjtë, tani e përherë e në jetë të jetëve.

**Lexuesi**

**(Anagnosti):** Amin.

Beko, o Atë, me emrin e Zotit.

**Prifti:** (*me zë të lartë*) Lavdi Trinisë së Shenjtë, të njëqenshme, jetëbërëse dhe të pandarë, gjithnjë; tani e përherë e në jetë të jetëve.

**Psaltët:** Amin.

*Pastaj thuhen gjashtë psalmet me përulësi dhe frikë Perëndie.*

### **Lexuesi**

**(Anagnosti):** Lavdi Perëndisë që është në më të lartat dhe mbi dhenë paqe dhe mbi njerëzit mirëdashje (*tri herë*).

O Zot, çel buzët e mia dhe goja ime do të lëçitë lavdinë tënde (*dy herë*).

### *Psalmi 3*

O Zot, sa u shumuan ata që më shtrëngojnë: Shumë ngrenë krye kundër meje.

Shumë i thonë shpirtit tim: s'ka shpëtim për atë te Perëndia i tij. Por ti, o Zot, je përkrahësi im, lavdia ime, dhe ai që më ngre kryet lart. Me zërin tim i thirra Zotit dhe më dëgjoi prej malit të tij të shenjtë. Unë rashë e fjeta, u ngrita se Zoti do të më ndihmojë.

Nuk do të frikësohem prej popullit të panumërt që më mësyjnë së bashku nga të gjitha anët.

Ngrihu, o Zot, shpëtomë, o Perëndia im; se ti godite të gjithë ata që kot janë armiqtë e mi, dërmon dhëmbët e mëkatarëve.

Nga Zoti është shpëtimi. Bekimi yt qoftë mbi popullin tënd.

*Dhe përsëri:*

Unë rashë e fjeta, u ngrita se Zoti do të më ndihmojë.

### *Psalmi 37*

O Zot, mos më qorto në zemërimin tënd, as mos më mundo në mërinë tënde.

Se shigjetat e tua m'u ngulën, dhe dora jote rëndon mbi mua.

Nuk ka shërim në trupin tim nga shkaku i zemërimit tënd; nuk ka paqe ndër eshtërat e mia nga shkaku i mëkateve të mia.

Se paudhësitë e mia kapërcyen kryet tim, si barrë e rëndë rënduan mbi mua.

U qelbën dhe u kalbën plagët e mia për shkak të marrëzisë sime.

U bëra i ngratë dhe u krusa krejt, gjithë ditën ecja i vrerët.

Se të brendshmet e mia u mbushën me nxehtësi dhe nuk ka shërim në trupin tim.

U dobësova dhe u këputa fare, ulërij, nga shtrëngimi i zemrës sime.  
O Zot, e gjithë dëshira ime është përpara teje dhe psherëtima ime nuk fshihet nga ty.

Zemra ime u trondit, fuqia ime më la, dhe dritën e syve të mi, as atë s'e kam.

Miqtë dhe të afërmit e mi u afruan dhe qëndruan kundrejt meje, ndërsa farefisi im qëndruan larg.

Dhe ata që kërkojnë shpirtin tim, ngrehin kurthe, edhe ata që më duan të keqen, flasin kotësira dhe tërë ditën mendojnë dinakëri.

Por unë nuk dëgjoja si një i shurdhër dhe nuk e çelja gojën si një memec.  
Dhe u bëra porsì një njeri që nuk dëgjon dhe që nuk ka përgjigje në gojën e tij.

Se shpresova te ty, o Zot, ti do të më dëgjosh, o Zot, Perëndia im.  
Se thashë: Mos u gëzofshin kurrë për mua armiqtë e mi; dhe kur më rrëshqasin këmbët ata mburren përpara meje.

Jam gati për të rënë, dhe dhimbja ime është përherë përpara meje.  
Se unë rrëfej paudhësinë time dhe më vjen rëndë për mëkatin tim.  
Por armiqtë e mi rrojnë edhe janë më të fortë se unë, dhe u shumuan ata që më urrejnë padrejtësisht.

Edhe ata që ma shpërblejnë të mirën me të keqe shpifin kundër meje, sepse unë ndjek të mirën.

Mos më neverit, o Zot, Perëndia im, mos u largo prej meje.  
Nxito të më ndihmosh, o Zot i shpëtimit tim.

### *Dhe përsëri:*

Mos më neverit, o Zot, Perëndia im, mos u largo prej meje.  
Nxito të më ndihmosh, o Zot i shpëtimit tim.

### *Psalmi 62*

O Perëndi, Perëndia im; tek ti shpejtoj që në mëngjes.

Shpirti im ka etje për ty dhe veçan trupi im, si në dhe të shkretë, të pakaluar dhe pa ujë.

Kështu t'u paraqita në shenjtëroren, që të shoh fufqinë tënde dhe lavdinë tënde.

Se përdëllimi yt është më i mirë se jeta, dhe buzët e mia do të të lavdërojnë.

Kështu do të bekoj në jetën time, dhe në emërin tënd do të ngre duart e mia.

Posi prej të majmi dhe prej dhjami le të nginjet shpirti im dhe me buzë ngazëllimi do të të lavdërojë goja ime.

Sa herë të kujtoja në shtratin tim, të kisha ndër mend gjer në mëngjes. Se u bëre ndihmësi im dhe në hijen e krahëve të Tu do të ngazëllohem. Shpirti im u ngjit pas teje dhe mua më ndihmoi e djathta jote. Po ata që kërkuan më kot shpirtin tim, do të hyjnë në anët më të poshtme të dheut.

Do të kositen nga fuqia e shpatës dhe do të bëhen pre dhelqërash. Dhe mbreti do të ngazëllehet më Perëndinë, do të lavdërohet cilido që betohet në emrin e tij, se u zu goja e atyre që flasin padrejtësira.

### *Dhe përsëri:*

Të kisha ndër mend gjer në mëngjes se u bëre ndihmësi im dhe në hijen e krahëve të tu do të ngazëllehem.

Shpirti im u ngjit pas teje dhe mua më ndihmoi e djathta jote.

Lavdi Atit e Birit edhe Shpirtit të Shenjtë, tani e përherë e në jetë të jetëve. Amin.

Aliluia, Aliluia, Aliluia lavdi me Ty, o Zot (*tri herë*).

Mëshiro, o Zot (*tri herë*).

Lavdi Atit e Birit edhe Shpirtit të Shenjtë, tani e përherë e në jetë të jetëve. Amin.

### *Psalmi 87*

O Zot, Perëndi i shpëtimit tim, ditë e natë thirra përpara teje.

Le të arrijë falja ime përpara Teje, vëri veshin lutjes sime.

Se shpirti im u mbush me të liga dhe jeta ime iu afrua ferrit.

U numërova me ata që zbresin në gropë, u bëra si njeri pa ndihmë, ndër të vdekurit i lirë. Posi të vvarët e shtrirë në varr, të cilët Ti nuk i kujtove më, po u flakën prej dorës sate.

Më vure në gropën më të thellë, në errësirën dhe në hijen e vdekjes.

Mbi mua rëndoi zemërimi yt dhe tërë valët e tua i solle mbi mua.

Largove prej meje të njohurit e mi, të cilët më morën për njeri të ndyrë.

U mbylla dhe s'mund të dal; sytë e mi u dobësuan nga vuajtjet; te

Ti, O Zot, thirra tërë ditën, te Ti ndeva duart e mia.

Mos do të bësh çudira në të vdekurit, apo të vdekurit do të ngrihen dhe do të të lavdërojnë?

Mos ka për të treguar kush, mëshirën tënde në varr, dhe të vërtetën tënde në humbje?

Mos do të njihen çuditë e tua në errësirë, dhe drejtësia jote në dhe të harruar?

Por unë te Ti thirra, o Zot, dhe lutja ime te Ti do të arrijë që në mëngjes. Përse e hedh tutje shpirtin tim, o Zot, dhe e kthen fytyrën tënde prej meje?

Fatkeq jam unë dhe i munduar që në të ritë tim, dhe kur u lartësova, u ula dhe u hutova.

Mbi mua kaluan zemërimet e Tua dhe kërcënimet e Tua më tronditën krejt.

Tërë ditën më rrethuan si uji dhe më mbyllën nga të gjitha anët. Largove prej meje çdo mik dhe të afërm, dhe të njohurit e mi për shkak të fatkeqësisë.

#### *Dhe përsëri:*

O Zot, Perëndi i shpëtimit tim, ditë e natë thirra përpara Teje. Le të arrijë falja ime përpara Teje, veri veshin lutjes sime.

#### *Psalmi 102*

Beko Zotin, o shpirti im, edhe ti, o zemra ime, emrin e tij të shenjtë. Beko Zotin, o shpirti im, dhe mos harro tërë mirësitë e tij.

Atë që fal gjithë paudhësitë e tua, atë që shëron gjithë sëmundjet e tua. Atë që shpëton jetën tënde prej prishjes, atë që të kurorëzon me mëshirë dhe dhembshuri.

Atë që ta mbush dëshirën me të mira; atë që përtërit të ritë e tu si të shqiponjës.

Zoti tregon mëshirë dhe u jep të drejtë atyre që u bëhet padrejtësi. Ia bëri të njohura udhët e Tij Moisiut, dëshirat e Tij bijve të Izraelit. Zoti është i dhembshur dhe përdëllyes, zemërgjërë dhe mëshirëplotë; nuk zemërohet përgjithmonë, as mban mëri për jetë.

Nuk veptoi simbas paudhësive tona, as na shpërbleu sipas mëkateve tona.

Sa e madhe është lartësia e qiellit nga dheu, aq e madhe është mëshira që tregon Zoti për ata që ia kanë frikën.

Sa larg është lindja nga perëndimi aq i largoi prej nesh paudhësitë tona. Sikurse atit i dhimbsen të bijtë, ashtu edhe Zotit i dhimbsen ata që ia kanë frikën.

Se ai e di se jemi krijuar dhe sjell ndërmend se jemi baltë.

Ditët e njeriut janë si bari, lulëzon porsi lulja e fushës.

Se fryn era mbi të dhe s'është më, edhe nuk dihet më se ku e ka pasur vendin.

Po mëshira e Zotit, jetë pas jete, është mbi ata që ia kanë frikën, dhe drejtësia e tij mbi bijtë e bijve, që ruajnë dhiatën e tij dhe që mbajnë ndër mend porositë e tij për t'i zbatuar.

Zoti e vendosi fronin e tij në qiell, dhe mbretëria e tij zotëron mbi të gjithë.

Bekoni Zotin gjithnjë ju engjëjt e tij, të fortë nga fuqia, që zbatoni porositë e tij, duke dëgjuar zërin e fjalëve të tij.

Bekoni Zotin gjithë ju fuqitë e tij, ju shërbyesit e tij, që zbatoni dëshirën e tij.

Bekoni Zotin gjithë ju veprat e tij, në çdo vend të sundimit të tij, beko Zotin, o shpirti im.

### *Dhe përsëri:*

Në çdo vend të sundimit të tij, beko Zotin, o shpirti im.

### *Psalmi 142*

O Zot, dëgjo faljen time, veri veshin lutjes sime simbas së vërtetës sate, dëgjomë simbas drejtësisë sate.

Dhe mos hyrë në gjyq me shërbëtorin tënd, se asnjë i gjallë nuk do të dalë i drejtë përpara teje.

Se armiku ma ndoqi shpirtin, dhe ma rrëzoi jetën për dhe.

Më vuri në vende të errëta, si të vdekurit prej kohe, shpirti m'u trishtua dhe zemra m'u trondit.

Kujtova ditët e lashta, mendova gjithë veprat e tua, sillja ndër mend punët e duarve të tua.

I shtriva duart drejt teje; shpirti im ka etje për ty si toka e thatë. Dëgjomë shpejt, o Zot, m'u zu fryma, mos e kthe mënjane fytyrën tënde prej meje, që të mos bëhem si ata që zbritën në varr.

Bëj që të dëgjoj përdëllimin tënd në mëngjes se më ty shpresova.

Tregomë, o Zot, udhën ku duhet të eci, se më ty e kam varur shpirtin. Shpëtomë prej armiqve të mi, o Zot, se tek ti kërkoja strehë. Mësomë të, bëj dëshirën tënde se ti je Perëndia im.

Fryma jote e mirë, do të më udhëheqë në vend të drejtë. Për emrin tënd, o Zot, gjallëromë.

Sipas drejtësisë sate nxirr shpirtin tim nga trishtimi, dhe sipas mëshirës sate shfarosi armiqtë e mi, dhe shkatërroi të gjithë ata që hidhërojnë shpirtin tim se unë jam shërbëtori yt.

*Dhe përsëri:*

Dëgjomë, o Zot, simbas drejtësisë sate dhe mos hyrë në gjyq me shërbëtorin tënd.

Dëgjomë, o Zot, simbas drejtësisë sate dhe mos hyrë në gjyq me shërbëtorin tënd.

Fryma jote e mirë do të më udhëheqë në vend të drejtë.

Lavdi Atit e Birit edhe Shpirtit të Shenjtë, tani e përherë e në jetë të jetëve. Amin.

Aliluia, Aliluia, Aliluia, lavdi Ty, o Perëndi (*tri herë*). O Zot shpresa jonë, lavdi me Ty.

*Në kohën që këndohen gjashtë psalmet, prifti qëndron përpara Altarit pa kalimaf dhe me respekt e frikë Perëndie lexon pa zë uratat e mëngjesit. Në mbarim të tre psalmeve të para (psalmet 3, 37 dhe 62), kur lexuesi (anagnosti) thotë «Lavdi ...», prifti del nga altari ngadalë dhe vazhdon leximin e uratave përpara ikonës së Krishtit.*

**Urata I:** Të falenderojmë, o Zot, Perëndia ynë, Ty që na ngrite nga shtretërit tanë dhe që ve në gojën tonë fjalë lavdërimi, për t'u falur dhe për të thirrur emrin tënd të shenjtë; dhe lypim dhembshuritë e tua që ti ke treguar për jetën tonë. Edhe tani dërgo ndihmën tënde mbi ata që qëndrojnë përpara fytyrës së lavdisë tënde të shenjtë dhe që presin prej teje mëshirën e pasur; dhe atyre që të adhurojnë gjithmonë me frikë dhe dashuri, jepu që të lavdërojnë, të himnojnë dhe t'i falen mirësisë sate së patreguar. Se ty të përket tërë lavdia, nderimi dhe adhurimi, Atit e Birit edhe Shpirtit të Shenjtë, tani e përherë e në jetë të jetëve. Amin.

**Urata II:** Që me natë, mëngon shpirti ynë për ty, o Perëndia ynë, se urdhërimet e tua janë dritë mbi dhe; bëna të mençëm që të kryejmë me frikën tënde punë drejtësie dhe shenjtërimi; Se ty të lavdërojmë që je vërtet Perëndia ynë; ul veshin tënd dhe dëgjona. Dhe kujto, o Zot, emër për emër të gjithë ata që ndodhen këtu dhe falen bashkë me ne, dhe shpëtoi me fuqinë tënde; beko popullin tënd, dhe shënjtëro trashëgimin tënd; fali paqe botës tënde, Kishave të tua, priftërinjve, prijësve tanë dhe gjithë popullit tënd. Se është i bekuar dhe i lavdëruar emri i yt i gjithënderuar dhe madhështor i Atit, i Birit dhe i Shpirtit të Shenjtë, tani e përherë e në jetë të jetëve. Amin.

**Urata III:** Që me natë mëngon shpirti ynë për ty, o Perëndi, se urdhërimet e tua janë dritë; mësona o Perëndi, drejtësinë tënde, porositë e tua dhe urdhërat e tua; ndriço sytë e mendjeve tona, se mos na zerë dikur gjumi ndër mëkate për vdekje; dëbo çdo errësi nga zemrat tona; falna diellin e drejtësisë dhe ruaje jetën tonë të paprekur me anën e vulës së shpirtit tënd të shenjtë. Drejtoi hapat tona në rrugë paqeje; falna mëngjesin dhe ditën me ngazëllim që të të drejtojmë lutjet e mëngjesit. Se yti është pushteti dhe jotja është mbretëria dhe fuqia dhe lavdia e Atit, e Birit dhe e Shpirtit të Shenjtë, tani e përherë e në jetë të jetëve. Amin.

**Urata IV:** O Zot Perëndi, i shenjtë dhe e pakuptueshëm për mendjen tonë, ti që the të ndrisë dritë nga errësira, ti që na çlodhe me gjumin e natës dhe na ngrite për të lavdëruar dhe për t'iu lutur mirësisë sate, i zbutur nga vetë mëshira jote, pranona dhe tani që po të falemi dhe të falenderojmë sipas fuqisë; dhe dhurona gjithë sa të lypim për shpëtim; tregona bij drite dhe dite, dhe trashëgimtarë të të mirave të tua të amëshuara. Kujto, o Zot, simbas përdëllimeve të tua të shumta, dhe tërë popullin tënd, ata që ndodhen këtu dhe falen bashkë me ne dhe tërë vëllezërit tanë në tokë, në det dhe në çdo vënd të zotërimit tënd, që kanë nevojë për njeridashjen dhe ndihmën tënde, dhe jepu të gjithëve mëshirën tënde të madhe. Që, të shpëtuar përgjithmonë shpirtërisht dhe trupërisht, të lavdërojmë pa ndrojtje emrin tënd të çuditshëm dhe të bekuar të Atit, të Birit dhe të Shpirtit të Shenjtë, tani e përherë e në jetë të jetëve. Amin.

**Urata V:** O thesar i të mirave, burim i pashterrur, Atë i Shenjtë çudibërës, i tërëfuqishëm dhe i plotpushtetshëm, të gjithë ne duke lypur mëshirat dhe dhembshuritë e tua, të falemi dhe të lutemi të na ndihmosh dhe të na përkrahësh ne të përlurur. Kujto, o Zot, lutësit e tu; prano nga të gjithë ne lutjet e mëngjesit, si temjam përpara teje, dhe mos bëj asnjë nga ne të padenjë, por, ruajna të gjithë me dhembshuritë e tua. Kujto, o Zot, ata që e gdhinë duke psalur për të lavdëruar Ty, Birin tënd të vetëmlindur dhe Perëndinë tonë, dhe Shpirtin tënd të shenjtë. Bëhu ndihmës dhe përkrahës i tyre; prano lutjet e tyre, në altar tënd që ndodhet përmbi qiejt dhe që kuptohet me anë të mendjes. Se Ti je Perëndia ynë, dhe ty ta drejtojmë lavdinë, Atit e Birit edhe Shpirtit të Shenjtë, tani e përherë e në jetë të jetëve. Amin.

**Urata VI:** Të falenderojmë, o Zot, Perëndi e shpëtimit tonë, se të gjitha i bën për të mirën e jetës sonë, që përgjithmonë t'i kemi sytë tek Ti, shpëtimtar dhe mirëbërës i shpirtit tanë; se na çlodhe natën e kaluar, na ngrite nga shtretërit tanë dhe na bëre që të qëndrojmë më këmbë për t'iu falur emrit tënd të nderuar. Prandaj, të lutemi, o Zot, jepna hiri dhe fuqi që të bëhemi të denjë të psalim me urti dhe të të falemi pa ndërprerje duke punuar me frikë dhe tmerr për shpëtimin, me ndihmën e Krishtit tënd. Kujto, o Zot, edhe ata që thërresin më Ty natën; dëgjoji dhe mëshiroi dhe dërrmo nën këmbët e tyre armiqtë e dukshëm dhe të padukshëm. Se ti je mbreti i paqes dhe shpëtimtar i shpirtit tanë dhe ty ta drejtojmë lavdinë, Atit e Birit edhe Shpirtit të Shenjtë, tani e përherë e në jetë të jetëve. Amin.

**Urata VII:** O Perëndi dhe Atë i Zotit tonë Iisu Krisht, Ti që na ngrite nga shtretërit tanë dhe na mblodhe në orën e faljes, na jep hiri në çeljen e gojës sonë dhe prano falenderimet simbas fuqisë; dhe na mëso porositë e tua se nuk dimë si të falemi në qoftë se Ti, o Zot, nuk na udhëheq me Shpirtin tënd të Shenjtë. Prandaj të lutemi, në qoftë se bëmë ndonjë mëkat deri në orën e tanishme me fjalë, me punë apo me mendje, me dashje ose padashje, dobësoje, fale, ndjeje. Se po të vesh re paudhësitë, o Zot, o Zot, kush ka për të qëndruar? se pranë Teje është shpëtimi. Ti je i vetëm shenjt, ndihmës, mbrojtës

i fuqishëm i jetës sonë dhe Ty të himnojmë për herë. Qoftë i bekuar dhe i lavdëruar pushteti i mbretërisë sate, i Atit dhe i Birit dhe i Shpirtit të Shenjt, tani e përherë e në jetë të jetëve. Amin.

**Urata VIII:** O Zot Perëndia ynë, Ti që largove prej nesh plogështinë e gjumit dhe na mblodhe bashkë me ftesë të shenjtë, që t'i ngremë lart duart tona edhe natën, dhe të rrëfëhemi përpara Teje simbas gjykimëve të drejtësisë sate, pranoi lutjet tona, kërkesat, rrëfimet, faljet e natës; dhe dhurona, o Perëndi, besë të paturpëruar, shpresë të sigurt, dashuri të kulluar. Bekona hyrjet dhe daljet, punët, veprat, fjalët, mendimet; dhe jepna që të arrijmë fillimin e ditës, duke lavdëruar, himnuar dhe bekuar mirësinë e dhembshurisë sate të patreguar. Se i bekuar është emri i yt i tërëshenjtë dhe e lavdëruar mbretëria jote, e Atit e Birit dhe e Shpirtit të Shenjtë, tani e përherë e në jetë të jetëve. Amin.

**Urata IX:** O Zot njeridashës, bëj që të ndritë në zemrat tona, drita e pashuar e njohjes së hyjnisë sate dhe hapi sytë e mendjes sonë për të kuptuar mësimet e tua ungjillore. Kallna edhe frikën e porosive të tua të lumtura, që pasi të shtypim gjithë dëshirat trupore, të kalojmë një jetë shpirtërore, duke menduar dhe duke vepruar gjithë ato, që janë të pëlqyera prej Teje. Se Ti je shenjtërimi ynë dhe ty ta drejtojmë lavdinë, Atit e Birit edhe Shpirtit të Shenjtë, tani e përherë e në jetë të jetëve. Amin.

**Urata X:** O Zot Perëndia ynë, Ti që u dhurove njerëzve ndjesën me anën e pendimit dhe na dhe si shembull njohjeje të mëkateve dhe të rrëfimit, pendimin e profetit David, për falje; Ti pra, o Zot, ne që kemi rënë në faje të shumta e të mëdha, mëshirona sipas mëshirës sate të madhe dhe sipas dhembshurive të tua të shumta, shuaji paudhësitë tona; se përpara Teje kemi mëkatuar, o Zot, i cili di të patreguarat dhe të fshehtat e zemrës së njerëzve, dhe je i vetëm që ke pushtet të falësh mëkate. Ti që vendose ndër ne zemër të pastër dhe na forcove me frymë sunduese dhe na bëre të njohur ngazëllimin e shpëtimit tënd, mos na hidh larg fytyrës sate; por dënjo si i mirë dhe njeridashës që të të sjellim therore drejtësie dhe blatë në altarët e tu të shenjtë gjer në frymën tonë të fundit. Me mëshirën dhe dhembshuritë dhe

njeridashjen e Birit tënd të vetëmlindur, me të cilin je i bekuar, bashkë me Shpirtin tënd të tërëshenjtë, të mirë dhe jetëbërës, tani e përherë e në jetë të jetëve. Amin.

**Urata XI:** O Perëndi, Perëndia ynë, Ti që ia nënshtrove vullnetit tënd fuqitë e kuptuara vetëm me anën e mendjes dhe fuqitë logjike, Ty të lutemi e të biem ndër këmbë; prano lavdërimin tonë simbas fuqisë bashkë me të gjitha krijesat e tua, dhe shpërblena me dhuratat e pasura të mirësisë sate; se përpara teje gjunjëzohen gjithë qiellorët, të dheshmet e të nëndheshmet dhe çdo frymë e çdo krijesë himnon lavdinë tënde të pakuptuar; se Ti je i vetmi Perëndi i vërtetë dhe e shumëmëshirshëm. Se Ty të këndojnë gjithë fuqitë e qiejve dhe Ty ta drejtojnë lavdinë, Atit e Birit edhe Shpirtit të Shenjtë, tani e përherë e në jetë të jetëve. Amin.

**Urata XII:** Të lavdërojmë, të himnojmë, të bekojmë dhe të falendërojmë, o Perëndi i etërve tanë, se e hoqe mënjane hijen e natës dhe na tregove përsëri dritën e ditës. Por i lutemi mirësisë sate: falna mëkatet tona dhe pranoje lutjen tonë me dhembshurinë tënde të madhe se gjejmë strehë tek Ti, Perëndi përdëllyes dhe i tërëfuqishëm. Bëj që të ndritë ndër zemrat tona Dielli i vërtetë i drejtësisë sate; ndriço mëndjen tonë dhe ruaj tërë shqisat tona, që duke ecur në rrugën e porosive të tua me hijeshi, si në dritën e ditës, të arrijmë në jetën e amëshuar; se pranë Teje është burimi i jetës; dhe të bëhemi të denjë të gëzojmë, dritën e paafruar. Se Ti je Perëndia ynë dhe Ty ta drejtojmë lavdinë, Atit e Birit edhe Shpirtit të Shenjtë, tani e përherë e në jetë të jetëve. Amin.

*Pasi mbarohen gjashtë psalmet dhiaku del nga dera e veriut, qëndron përpara Derës së Bukur dhe thotë paqësoret. Në mungesë të dhiakut, i thotë prifti përpara Tryezës së Shenjtë.*

**Dhiaku:** Me paqe le t'i lutemi Zotit.

**Psaltët:** Mëshiro, o Zot.

**Dhiaku:** Për paqen që lartazi, dhe për shpëtimin e shpirttrave tanë, le t'i lutemi Zotit.

- Psaltët:** Mëshiro, o Zot.
- Dhiaku:** Për paqen e tërë botës, qëndrimin e mirë të Kishave të shenjta të Perëndisë, dhe për bashkimin e të gjithëve, le t'i lutemi Zotit.
- Psaltët:** Mëshiro, o Zot.
- Dhiaku:** Për këtë shtëpi të shenjtë dhe për ata që hyjnë brenda në të me besë, shpresëtari dhe frikë Perëndie, le t'i lutemi Zotit.
- Psaltët:** Mëshiro, o Zot.
- Dhiaku:** Për Kryepiskopin (*ose* episkopin) tonë (*aksh*), të nderuarën presviteri dhe dhiakonatën më Krishtin, për tërë klerin dhe popullin, le t'i lutemi Zotit.
- Psaltët:** Mëshiro, o Zot.
- Dhiaku:** Për Republikën e Shqipërisë, qeverinë, ushtrinë dhe gjithë popullin, le t'i lutemi Zotit.
- Psaltët:** Mëshiro, o Zot.
- Dhiaku:** Për këtë qytet (*ose* manastir të shenjtë), çdo qytet dhe vend dhe për ata që banojnë në to me besë, le t'i lutemi Zotit.
- Psaltët:** Mëshiro, o Zot.
- Dhiaku:** Për erëra të mira, begati të pemëve të dheut, dhe për kohë me paqe, le t'i lutemi Zotit.
- Psaltët:** Mëshiro, o Zot.
- Dhiaku:** Për ata që lundrojnë, që udhëtojnë, për të sëmurët, vuajtësit, robërit, dhe për shpëtimin e tyre, le t'i lutemi Zotit.
- Psaltët:** Mëshiro, o Zot.
- Dhiaku:** Që të shpëtojmë prej çdo hidhërimi, zemërimi, rreziku dhe nevoje, le t'i lutemi Zotit.
- Psaltët:** Mëshiro, o Zot.

- Dhiaku:** Përkrahna, shpëtona, mëshirona dhe ruajna, o Perëndi, me hirin tënd.
- Psaltët:** Mëshiro, o Zot.
- Dhiaku:** Të Tërëshenjtën, të pacënuarën, të përmbibekuarën, të lavdëruarën Zonjën tonë Hyjlindëse dhe gjithmonë Virgjërën Mari, bashkë me gjithë shenjtorët, duke e kujtuar, veten tonë dhe njeri-tjetrin dhe gjithë jetën tonë, Krishtit Perëndisë, le t'ia parashtrijmë.
- Psaltët:** Ty, o Zot.
- Prifti:** *(me zë të lartë)* Se Ty të përket tërë lavdia, nderimi dhe adhurimi, Atit e Birit edhe Shpirtit të Shenjtë, tani e përherë e në jetë të jetëve.
- Psaltët:** Amin.
- Psaltët:** Perëndi është Zoti dhe u shfaq ndër ne, i bekuar është ai që vjen në emrin e Zotit *(katër herë me këto vargje duke filluar nga hera e dytë)*.
- Vargu I:* Rrëfëhuni te Zoti dhe thirrni emrin e tij të shenjtë.
- Vargu II:* Të gjithë kombet më rrethuan dhe me emrin e tij i mposhta.
- Vargu III:* Prej Zotit u bë kjo dhe është e çuditshme në sytë tanë.
- Gjatë Kreshmëve të mëdha në vend të* «Perëndi është Zoti ...» *dhe tropeve të tjerë thuhet* «Aliluia, Aliluia, Aliluia» *katër herë, me këto vargje:*
- Vargu I:* Që me natë mëngon shpirti im për Ty, o Perëndi, se urdhërimet e tua janë dritë mbi dhe.
- Vargu II:* Mësoni drejtësinë ju banorët e dheut.
- Vargu III:* Smira do ta pushtojë popullin e pamësuar, dhe tani zjarri do t'i përpijë kundërshtarët.
- Vargu IV:* Shtojua të këqiat, o Zot, shtojua të këqiat, kryelartëve të dheut.

*Pas «Aliluia» psalen himnet trinisorë (triadhikë) të tingullit përkatës.*

*Pastaj këndohet tropari i ditës dy herë dhe hyjlindësorja (theoqion) e të njëjtit tingull. Po të ketë dy tropare (e shenjtit ose e triodhit ose e pendikostarit), tropari i parë thuhet dy herë, i dyti një herë dhe hyjlindësorja sipas tingullit të troparit të fundit.*

*Pastaj psalen stihologjitë ose kathizmat (vargëzimet). Në mbarim të stihologjisë së parë dhiaku ose prifti thotë:*

**Dhiaku:** Përsëri dhe përsëri me paqe le t'i lutemi Zotit.

**Psaltët:** Mëshiro, o Zot.

**Dhiaku:** Përkrahna, shpëtona, mëshirona, dhe ruajna, o Perëndi, me hirin tënd.

**Psaltët:** Mëshiro, o Zot.

**Dhiaku:** Të Tërëshenjtën, të pacënuarën, të përmbibekuarën, të lavdëruarën Zonjën tonë Hyjlindëse dhe gjithmonë Virgjërën Mari, bashkë me gjithë shenjtorët, duke e kujtuar, veten tonë dhe njeri-tjetrin dhe gjithë jetën tonë, Krishtit Perëndisë, le t'ia parashtrojmë.

**Psaltët:** Ty, o Zot.

**Prifti:** *(me zë të lartë)* Se yti është pushteti dhe jotja është mbretëria dhe fuqia dhe lavdia e Atit, e Birit dhe e Shpirtit të Shenjtë, tani e përherë e në jetë të jetëve.

**Psaltët:** Amin.

*Në mbarim të stihologjisë së dytë dhiaku (ose prifti) thotë:*

**Dhiaku:** Përsëri dhe përsëri me paqe, le t'i lutemi Zotit.

**Psaltët:** Mëshiro, o Zot.

**Dhiaku:** Përkrahna, shpëtona, mëshirona, dhe ruajna, o Perëndi, me hirin tënd.

**Psaltët:** Mëshiro, o Zot.

**Dhiaku:** Të Tërëshenjtën, të pacënuarën, të përmbibekuarën, të lavdëruarën Zonjën tonë Hyjllindëse dhe gjithmonë Virgjërën Mari, bashkë me gjithë shenjtoret, duke e kujtuar, veten tonë dhe njeri-tjetrin dhe gjithë jetën tonë, Krishtit Perëndisë, le t'ia parashtrojmë.

**Psaltët:** Ty, o Zot.

**Prifti:** *(me zë të lartë)* Se ti je Perëndi i mirë dhe njeridashës dhe Ty ta drejtojmë lavdinë, Atit e Birit edhe Shpirtit të Shenjtë, tani e përherë e në jetë të jetëve.

**Psaltët:** Amin.

*Dhe menjëherë fillojnë bekimtorët e ngjalljes Ting. Tërth. I-rë.*

**Psaltët:** I bekuar je, o Zot, mësomë porositë e tua.

Të gjithë engjëjt u çuditën, kur të panë që u numërove ndër të vdekurit, që rrëzove shpëtimtar fuqinë e vdekjes, që ndrite Adamin bashkë me veten tënde dhe që i çlirove të gjithë prej skëterrës.

I bekuar je, o Zot, mësomë porositë e tua.

Përse i përziëni, o nxënëse mirat me lotet e dhimbjes. Engjëlli që shkëlqente në varr, u thoshte mirasjellëseve: Shikojeni vetë varrin dhe gëzohuni se Shpëtimtari u ngrit prej varrit.

I bekuar je, o Zot, mësomë porositë e tua.

Herët në mëngjes, mirasjellëset vrapuan te varri yt duke vajtuar, po u qëndroi përpara engjëlli dhe u tha: Koha e vajtimit shkoi, mos qani, po ngjalljen Apostujve thuajani.

I bekuar je, o Zot, mësomë porositë e tua.

Gratë mirasjellëse, duke ardhur me mira, te varri yt, o Shpëtimtar, dëgjuan engjëllin që u thoshte: Pse e numë-

roni të gjallin ndër të vdekurit. Se ai u ngrit prej varrit si Perëndi.

Lavdi Atit e Birit edhe Shpirtit të Shenjtë.

I falemi Atit e Birit të tij edhe Shpirtit të Shënjtë; Trinisë së Shenjtë të njëqenshme duke thirrur bashkë me Serafiimet: I shenjtë, i shenjtë, i shenjtë je, o Zot.

Tani e përherë e në jetë të jetëve, Amin.

Duke lindur Jetëdhënësin, shpëtove, o virgjëreshë Adamin prej mëkatit, edhe Evës i dhe gëzim në vend të helmit; atë që ra nga jeta e drejtoi tek ajo, Perëndi-njeriu që mori trup prej teje.

Alilua, Alilua, Alilua, lavdi ty, o Perëndi (*tri herë*).

**Dhiaku ose**

**prifti:** Përsëri dhe përsëri me paqe, le t'i lutemi Zotit.

**Psaltët:** Mëshiro, o Zot.

**Dhiaku:** Përkrahna, shpëtona, mëshirona, dhe ruajna, o Perëndi, me hirin tënd.

**Psaltët:** Mëshiro, o Zot.

**Dhiaku ose**

**prifti:** Të Tërëshenjtën, të pacënuarën, të përmbibekuarën, të lavdëruarën Zonjën tonë Hyjlindëse dhe gjithmonë Virgjërën Mari, bashkë me gjithë shenjtorët, duke e kujtuar, veten tonë dhe njeri-tjetrin dhe gjithë jetën tonë, Krishtit Perëndisë, le t'ia parashtröjmë.

**Psaltët:** Ty, o Zot.

**Prifti:** (*me zë të lartë*) Se i bekuar është emri yt dhe e lavdëruar mbretëria jote, e Atit, e Birit dhe e Shpirtit të Shenjtë, tani e përherë e në jetë të jetëve.

**Psaltët:** Amin.

*Pastaj thuhet ipakoi (vëmendja), andifonet (shkallët) e tingullit dhe paravargu i ngjalljes.  
Kur është ndonjë e kremte thuhet këto andifone të tingullit IV.*

**Psaltët:** Që prej rinisë sime, shumë pasione më luftojnë. Po ti përkrahmë dhe shpëtomë, o Shpëtimtari im.

Ju që urreni Sionin, kini turp nga Zoti, se do të thaheni si bari prej zjarrit.

Lavdi Atit e Birit edhe Shpirtit të Shenjtë.

Me anën e Shpirtit të Shenjtë, merr jetë çdo shpirt, dhe me pastrim lartësohet, dhe mistikisht ndriçohet prej njësisë trinisore.

Tani e përherë e në jetë të jetëve. Amin.

Me anën e Shpirtit të Shenjtë, rrjedhin burimet e hirit që vaditin tërë krijesën për rilindje jete.

*Psallet paravargu i së kremtës, Ungjilli i mëngjesit dhe kanonet.  
Të dielave pas paravargut të ngjalljes psalen kanonet e ngjalljes dhe i shenjtit në rast se ka. Pas këngës III:*

**Dhiaku ose  
prifti:**

Përsëri dhe përsëri me paqe, le t'i lutemi Zotit.

**Psaltët:** Mëshiro, o Zot.

**Dhiaku:** Përkrahna, shpëtona, mëshirona, dhe ruajna, o Perëndi, me hirin tënd.

**Psaltët:** Mëshiro, o Zot.

**Dhiaku:** Të Tërëshenjtën, të pacënuarën, të përmbibekuarën, të lavdëruarën Zonjën tonë Hyjlindëse dhe gjithmonë Virgjërën Mari, bashkë me gjithë shenjtorët, duke e kujtuar, veten tonë dhe njeri-tjetrin dhe gjithë jetën tonë, Krishtit Perëndisë, le t'ia parashtrojmë.

**Psaltët:** Ty, o Zot.

**Prifti:** *(me zë të lartë)* Se ti je Perëndia ynë dhe ty ta drejtojmë lavdinë, Atit e Birit edhe Shpirtit të Shenjtë, tani e përherë e në jetë të jetëve.

**Psaltët:** Amin.

*Pastaj thuhet kathizma e mineos me kondaqin dhe ikosin e shenjtit. Pas këngës VI.*

**Dhiaku:** Përsëri dhe përsëri me paqe, le t'i lutemi Zotit.

**Psaltët:** Mëshiro, o Zot.

**Dhiaku ose**

**prifti:** Përkrahna, shpëtona, mëshirona dhe ruajna, o Perëndi, me hirin tënd.

**Psaltët:** Mëshiro, o Zot.

**Dhiaku:** Të Tërëshenjtën, të pacënuarën, të përmbibekuarën, të lavdëruarën Zonjën tonë Hyjllindëse dhe gjithmonë Virgjërenë Mari, bashkë me gjithë shenjtorët, duke e kujtuar, veten tonë dhe njeri-tjetrin dhe gjithë jetën tonë, Krishtit Perëndisë, le t'ia parashtrojmë.

**Psaltët:** Ty, o Zot.

**Prifti:** *(me zë të lartë)* Se ti je mbret i paqes dhe shpëtimtar i shpitrave tanë dhe Ty ta drejtojmë lavdinë, Atit e Birit edhe Shpirtit të Shenjtë, tani e përherë e në jetë të jetëve.

**Psaltët:** Amin.

*Thuhet Kondaqi dhe Ikosi nga Oktoihu dhe Sinaksari i shenjtit të ditës. Këndohet kënga VII e VIII dhe IX dhe menjëherë katavasitë. Pas këngës VIII:*

**Dhiaku:** Le t'i lutemi Zotit.

**Psaltët:** Mëshiro, o Zot.

**Prifti:** Se i Shenjtë je, o Perëndia ynë, dhe prehesh ndër shenjtorët dhe ty ta drejtojmë lavdinë, Atit e Birit edhe Shpirtit të Shenjtë, tani e përherë e në jetë të jetëve.

**Psaltët:** Amin.

Çdo frymë le të lavdërojë Zotin (*tri herë*).

**Dhiaku:** Dhe që të bëhemi të denjë për të dëgjuar Ungjillin e shenjtë, Zotit Perëndisë sonë le t'i lutemi.

**Psaltët:** Mëshiro, o Zot (*tri herë*).

**Dhiaku:** Urtësi, drejt. Le të dëgjojmë Ungjillin e shenjtë.

**Prifti:** Paqe në të gjithë.

**Psaltët:** Dhe në shpirtin tënd.

**Prifti:** Këndim prej Ungjillit të shenjtë sipas (*aksh*).

**Psaltët:** Lavdi me Ty, o Zot, lavdi me Ty.

**Dhiaku:** Le të vemë re.

*Prifti këndon Ungjillin e mëngjesit në anën e djathtë të Tryezës së Shenjtë kur është e dielë dhe në mes të Derës së Bukur kur është e kremte. Pas mbarimit të Ungjillit:*

**Psaltët:** Lavdi me Ty, o Zot, lavdi me Ty.

### **Lexuesi**

**(Anagnosti):** Ne që pamë ngjalljen e Krishti le t'i falemi të shenjtit, Zotit Iisu, të vetmit të pamëkatshëm. Kryqit tënd po i falemi, o Krisht, dhe ngjalljen tënde të shenjtë himnojmë dhe lavdërojmë; se ti je Perëndia ynë, veç teje nuk njohim tjetër, emrin tënd përmendim. Ejani gjithë besimtarët t'i falemi ngjalljes së shenjtë të Krishtit; se ja tek erdhi me anën e Kryqit gëzim në tërë botën; duke bekuar kurdoherë Zotin, himnojmë ngjalljen e Tij; se duke duruar kryqin për ne, me vdekje, vdekjen e zhduku.

*Në kohën kur psalet Psalmi 50 dhe pikërisht në vargun e gjashtë «Se ja tek deshe të vërtetën ...», prifti del me Ungjillin në mes të kishës për ta puthur besnikët.*

## *Psalmi 50*

**Psaltët:** Përdëllemë, o Perëndi, sipas përdëllimit tënd të madh dhe sipas dhembshurive të tua të shumta shuaje paudhësinë time.

Lajmë krejt prej paudhësisë sime dhe pastromë prej mëkatit tim.

Se unë e njoh paudhësinë time dhe mëkati im është përpara meje kurdoherë.

Te Ti vetëm mëkatova dhe të keqen e bëra përpara teje, kështu që ti je i drejtë në fjalët e tua dhe i kthjellët në gjykimin tënd.

Se ja tek u zura në paudhësi, dhe në mëkate më lindi nëna ime.

Se ja tek deshe të vërtetën, të patreguarat dhe të fshehtat e urtësisë sate m'i tregove.

Spërkatmë me hisop, dhe do të pastrohem, lajmë dhe do të bëhem më i bardhë se dëbora.

Bëmë të dëgjoj gëzim e ngazëllim, dhe do të më gëzohen eshtrat e dobësuara.

Ktheje fytyrën tënde nga mëkatet e mi, dhe shuaji gjithë paudhësitë e mia.

Krijë zemër të pastër tek unë, o Perëndi, dhe përtërit frymë të drejtë në thellësitë e zemrës sime.

Mos më hidh larg fytyrës sate, dhe mos e hiq prej meje Shpirtin tënd të Shenjtë.

Jepma prapë ngazëllimin e shpëtimit tënd, dhe forcomë me frymë sunduese.

Do t'u mësoj të paligjve udhët e tua, dhe të pabesët do të kthehen tek Ti.

Shpëtomë prej gjakrash, o Perëndi, Perëndia i shpëtimit tim, gjuha ime do të lavdërojë me gëzim drejtësinë tënde.

O Zot, çel buzët e mia, dhe goja ime do të lëçitë lavdinë tënde.

Se po të kisha dashur therore do të kisha prurë, por Ty s'të pëlqejnë theroret me djegie të plotë.

Therore ndaj Perëndisë është shpirti i dërrmuar; zemrën e dërrmuar dhe të përulur Perëndia nuk do ta përbuzë. Bëji të mirë, o Zot, Sionit, sipas mirëdashjes sate; dhe le të ndërtohen muret e Jeruzalemit.

Atëherë do të të pëlqejë therore drejtësie, dhurata dhe therore me djegie të plotë.

Atëherë do të sjellin viçer mbi altarin tënd dhe mëshiromë, o Perëndi.

**Psaltët:**

Lavdi Atit e Birit edhe Shpirtit të Shenjtë.

Me ndërmjetimet e Apostujve, o mëshirëplotë, shuaji mëkatet e mi të shumtë.

Tani e përherë e në jetë të jetëve. Amin.

Me ndërmjetimet e Hyjlindëses, o mëshirëplot shuaji mëkatet e mi të shumtë.

Përdëllyes, përdëllemë, o Perëndi, sipas përdëllimit tënd të madh dhe sipas dhembshurive të tua të shumta, shuaje paudhësinë time.

Kur u ngrit Iisui prej varrit siç paratha, na dha jetën e amëshuar dhe përdëllimin e madh.

---

*Gjatë periudhës së Tridhit edhe në Kreshmës thuhet këto të tingullit tërthor IV:*

Lavdi Atit e Birit edhe Shpirtit të Shenjtë.

Hapmi dyert e pendimit, o Jetëdhënës, se shpirti im vjen që me natë te tempulli yt i shenjtë, duke sjellë tempullin e trupit, krejt të përlyer. Po ti si i dhembshur pastroje me përdëllimin tënd të mëshirshëm.

Tani e përherë e në jetë të jetëve. Amin.

Drejtomë në rrugët e shpëtimit, o Hyjlindëse; sepse e ndota shpirtin me mëkate të turpshme, duke shkuar tërë jetën time me ngathtësi; me ndërmjetimet e tua spastromë prej çdo ndyrësie.

Përdëllyes, përdëllemë, o Perëndi, sipas përdëllimit tënd të madh dhe sipas dhembshurive të tua të shumta, shuaje paudhësinë time.

Unë i mjeri, duke kujtuar mëkatet e shumta dhe të tmerrshme që kam bërë, dridhem nga dita e frikshme e gjyqit; po duke marrë guxim nga mëshira e dhembshurisë sate, si Davidi po të thërres: Përdëllemë, o Perëndi, pas përdëllimit tënd të math.

---

*Po të jetë ndonjë e kremte brenda javës Psalmi 50 nuk psalet, por lexohet. Pas këtyre:*

**Dhiaku ose  
prifti:**

O Perëndi, shpëtoje popullin tënd dhe bekoje trashëgimin tënd. Vështroje botën tënde me mëshirë e dhembshuri. Lartësoje fuqinë e të krishterëve orthodhoksë dhe dërgo mbi ne mëshirat e tua të pasura, me ndërmjetimet e Zonjës sonë të pacënuar Hyjlindëses dhe gjithmonë Virgjërës Mari; me fuqinë e Kryqit të çmuar dhe jetëbërës; me mbrojtjet e fuqive qiellore të çmuara dhe të trupit; të nderuarit, të lavdëruarit profet, pararendësit dhe pagëzorit Joan; të Apostujve të shenjtë të lavdëruar dhe të dëgjuar; të Etërve tanë të shenjtë, mësuesve të mëdhenj eku-menikë dhe ierarkëve, Vasilit të Madh, Grigor Theollogut dhe Joan Gojartit; patrikëve të Aleksandrisë, Athanasit, Qirillit dhe Joan Përdëllimtarit; të çudibërësve, Shën Kollit Kryepiskopit të Mirës së Liqisë dhe Shën Spiridhonit episkopit të Trimithundës; të martirëve të shenjtë, të lavdëruar dhe mundës të shkëlqyer; të etërve tanë oshënarë dhe hyjprurës, të martirëve të shenjtë, të lavdëruar e të mëdhenj Gjergj Trofeprurësit, Dhimitër Mirovllit, Theodhor Tironit dhe Theodhor Stratillatit; të Hyjprindëve të shenjtë dhe të drejtë Joakim dhe Anës; të shenjtit (*të kishës*), të shenjtit (*të ditës*), që lusim sot dhe të gjithë shenjtoreve të tu. Ty të lutem, o i vetëm i shumë mëshirshëm Zot, dëgjona ne mëkatarët që po të lutemi dhe mëshirona.

**Psaltët:** Mëshiro, o Zot (*12 herë*).

**Prifti:** (*me zë të lartë*) Me mëshirën, dhembshuritë dhe njeridashjen e Birit tënd të vetëmlindur, me të cilin je i bekuar bashkë me Shpirtin tënd të Tërëshenjtë, të mirë dhe jetëbërës, tani e përherë e në jetë të jetëve.

**Psaltët:** Amin.

*Dhiaku nga mesi i Derës së Bukur thotë:*

**Dhiaku:** Hyjlindësen dhe Mëmën e Dritës duke nderuar me himnele ta madhërojmë.

**Psaltët:** *Vargu:* Shpirti im madhëron Zotin dhe mëndja ime u ngazëllua për Perëndinë, Shpëtimtarin tim.

Më të nderuarën se Keruvimet dhe më të lavdëruarën pa krahasim se Serafimet, që pa u cënuar linde Fjalën Perëndi, me të vërtetë Hyjlindësen, ty të madhërojmë.

*Vargu:* Se hodhi sytë mbi përlulësinë e shërbëtores së tij se ja që tani e tutje gjithë brezat do të më lumtuojnë.

Më të nderuarën se Keruvimet dhe më të lavdëruarën pa krahasim se Serafimet, që pa u cënuar linde Fjalën Perëndi, me të vërtetë Hyjlindësen, ty të madhërojmë.

*Vargu:* Se tek unë bëri vepra madhështore i Fuqishmi dhe i shenjtë është emri i tij; dhe përdëllimi i tij do të jetë brez pas brezi për ata që ia kanë frikën.

Më të nderuarën se Keruvimet dhe më të lavdëruarën pa krahasim se Serafimet, që pa u cënuar linde Fjalën Perëndi, me të vërtetë Hyjlindësen, ty të madhërojmë.

*Vargu:* Rrëfeu fuqi me krahun e tij; i shpërndau ata që krenohen me mendimin e zemrës së tyre.

Më të nderuarën se Keruvimet dhe më të lavdëruarën pa krahasim se Serafimet, që pa u cënuar linde Fjalën Perëndi, më të vërtetë Hyjlindësen, ty të madhërojmë.

**Vargu:** Përmbysi të fuqishmit prej froneve, dhe i lartësoi të përlurrit, të uriturit i mbushi me të mira, dhe të pasurit i dëboi të zbrazët.

Më të Nderuarën se Keruvimet dhe më të lavdëruarën pa krahasim se Serafimet, që pa u cënuar linde Fjalën Perëndi, me të vërtetë Hyjlindësen, ty të madhërojmë.

**Vargu:** Përkrahu të birin e tij Izrael, duke sjellë ndërmend mëshirën që u premtoi etërve tanë, Avraamit dhe farës së tij për jetë.

Më të Nderuarën se Keruvimet dhe më të lavdëruarën pa krahasim se Serafimet, që pa u cënuar linde Fjalën Perëndi, me të vërtetë Hyjlindësen, ty të madhërojmë.

**Këndohet kënga IX e katavasive dhe pas kësaj dhiaku qëndron në vendin e zakonshëm dhe thotë:**

**Dhiaku:** Përsëri dhe përsëri me paqe, le t'i lutemi Zotit.

**Psaltët:** Mëshiro, o Zot.

**Dhiaku ose**

**prifti:** Përkrahna, shpëtona, mëshirona dhe ruajna, o Perëndi, me hirin tënd.

**Psaltët:** Mëshiro, o Zot.

**Dhiaku:** Të Tërëshenjtën, të pacënuarën, të përmibekuarën, të lavdëruarën Zonjën tonë Hyjlindëse dhe gjithmonë Virgjërën Mari, bashkë me gjithë shenjtoret, duke e kujtuar, — veten tonë dhe njeri-tjetrin dhe gjithë jetën tonë, Krishtit Perëndisë, le t'ia parashtrojmë.

**Psaltët:** Ty, o Zot.

**Prifti:** *(me zë të lartë)* Se ty të lavdërojnë tërë fuqitë e qiejve dhe Ty ta drejtojnë lavdinë, Atit e Birit edhe Shpirtit të Shenjtë, tani e përherë e në jetë të jetëve.

**Psaltët:** Amin.

**Psaltët:** I shenjtë është Zoti, Perëndia ynë (*tri herë, por në të tretën shtohet dhe kjo*): Lartësoni Zotin Perëndinë tonë, dhe faljuni nënkëmbëses së këmbëve të Tij, se është i shenjtë.

*Psalet eksapostillari (Dërgimsorja) i ngjalljes me hyjlindësoren e tij (Theotoqion). Kur ka edhe shenjtë eksapostillar, pas atij të ngjalljes psalet eksapostillari i shenjtit dhe hyjlindësorja e tij dhe pastaj lavdërimet sipas tingullit.*

**Psaltët:** Çdo frymë le të lavdërojë Zotin. Lavdërojeni Zotin prej qiejvë, lavdërojeni në më të lartat; Ty të ka hije himni, o Perëndi.

Lavdërojeni gjithë engjëjt e tij, lavdërojeni gjithë fuqitë e tij; Ty të ka hije himni, o Perëndi.

*Kur të dielën bie ndonjë e kremte shenjtë ose e Hyjlindëses, ose e triodhit apo e pendikostarit, të katër lavdërimet e para thuhën të ngjalljes dhe katër të tjerat të së kremtes që takon. Përrjashtim bëjnë e diela e Birit të shturur, e djathit, e para dhe e dyta e kreshmëve kur thuhën pesë të ngjalljes dhe tre nga triodhi.*

*Kur nuk ka ndonjë të kremte thuhën që të teta të ngjalljes.*

#### *Vargjet e lavdërimeve*

Kjo lavdi do të jetë për të gjithë oshënarët e tij.

Lavdërojeni Perëndinë në shënjtoren e tij, lavdërojeni atë në vendin e shkëlqimit të fuqisë së tij.

Lavdërojeni për fuqitë e Tij; lavdërojeni sipas madhërisë së Tij të shumtë.

Lavdërojeni me zë trumbete; lavdërojeni me harpë dhe me kitarë.

Lavdërojeni me timpan dhe valle; lavdërojeni me kordha dhe instrumente.

Lavdërojeni me çimbale tingëlluese, lavdërojeni me çimbale brohoritjeje. Çdo frymë le të lavdërojë Zotin.

Ngrehu, o Zot, Perëndia im, le të lartësohet dora jote:  
mos i harro të varfërit e tu gjer në fund.

Do të të lavdëroj me gjithë zemër, o Zot, do të tregoj  
gjithë çuditë e tua.

*Pastaj thuhet Lavdia ... e mëngjesit (eothinon) e së dielës ose  
e triodhit, e pendikostarit, e etërve, e stërgjyshërve, apo e shenj-  
tit. Tani ... simbas tingullit të lavdisë, thuhet kjo:*

**Psaltët:** E përmbibekuar je, o Hyjlindëse Virgjëreshë; se me anën  
e atij që mori trup prej teje ferri u robërua, Adami u  
rithirr, mallkimi vdiq, Eva u çlirua, vdekja vdiq dhe ne  
u ngjallëm. Prandaj duke himnuar thërresim: I bekuar  
je, o Krisht Perëndia ynë, që të pëlqeu kështu, lavdi më Ty.

*Në qoftë e kremte e madhe në vënd të «E përmbibekuar je  
...» thuhet përlëshorja e së kremtes.*



# DHOKSOLOGJIA

## Psaltët:

Lavdi ty që na rrëfeve dritën, lavdi Perëndisë që është në më të lartat dhe mbi dhenë paqe, dhe mbi njerëzit mirëdashje.

Të himnojmë, të bekojmë, të falemi, të lavdërojmë, Ty të falenderojmë për lavdinë tënde të madhe.

Zot Mbret, Perëndi qiellor, Atë i tërëfuqishëm; Zot Bir i vetëmlindur Iisu Krisht, edhe Shpirtit të Shenjtë.

Zot Perëndi, qëngj i Perëndisë, Bir i Atit që ngre mëkatën e botës, mëshirona, Ti që ngre mëkatet e botës.

Prano lutjen tonë, Ti që rri në të djathtë të Atit, edhe mëshirona.

Se Ti je Shenjt i vetëm, Ti je Zot i vetëm, Iisu Krishti, për lavdi të Perëndisë Atit. Amin.

Për ditë do të të bekoj, dhe do të lavdëroj emrin tënd për jetë, e në jetë të jetës.

Bëna të denjë, o Zot, që të ruhemi këtë ditë pa ndonjë mëkat.

I bekuar je, o Zot, Perëndi i Eterve tanë, dhe emri yt është i himnuar dhe i lavdëruar në jetët. Amin.

Le të jetë, o Zot, përdëllimi yt mbi ne, sikurse kemi shpresuar tek Ti.

I bekuar je, o Zot, mësomë porositë e tua (*tri herë*).

O Zot u bëre streha jonë brez pas brezi, unë thashë: O Zot, mëshiromë, shëro shpirtin tim se fajtova tek Ti, O Zot, tek Ti gjeta strehë, mësomë të bëj dëshirën tënde se ti je Perëndia im.

Se pranë teje është burimi i jetës; me dritën tënde do të shohim dritë.

Zgjate përdëllimin tënd mbi ata që të njohin.

Shenjt Perëndi, Shenjt i fuqishëm, Shenjt i pavdekshëm, mëshirona (*tri herë*).

Lavdi Atit e Birit edhe Shpirtit të Shenjtë.

Tani e përherë e në jetë të jetëve. Amin.

Shenjt i pavdekshëm, mëshirona.

Shenjt Perëndi, Shenjt i fuqishëm, Shenjt i pavdekshëm, mëshirona.

Sot erdhi shpëtimi në botë, le t'i këndojmë atij që u ngrit prej varrit, kryetarit të jetës sonë; sepse dërrmoi vdekjen me vdekje dhe na dha fitoren dhe përdëllimin e madh.

*Gjatë kohës që psalet dhoksologjia:*

**Dhiaku ose**

**prifti:**

*(pa zë)* Mëshirona, o Perëndi, sipas mëshirës sate së madhe, të lutemi, dëgjo e mëshiro.

Lutemi edhe për të krishterët shpresëtarë dhe orthodhoksë.

Lutemi edhe për Kryepiskopin *(ose* episkopin) tonë *(aksh)*.

Lutemi edhe për vëllezërit tanë: priftërinjtë, ieromonakët, ierodhiakonët, monakët dhe për tërë vëllazërinë tonë më Krishtin.

Lutemi edhe për mëshirë, jetë, paqe, shëndet, shpëtim, vështrim, ndjesë dhe falje të mëkateve të shërbëtorëve të Perëndisë, gjithë të krishterëve shpresëtarë dhe orthodhoksë, që banojnë dhe ndodhen në këtë qytet *(ose* manastir), enoritëve, epitropëve dhe ndihmëtarëve të kësaj shtëpie të shenjtë.

Lutemi edhe për të lumturit dhe gjithmonëkujtueshmit themelues të kësaj shtëpie të shenjtë, dhe për tërë etërit dhe vëllezërit tanë të parafjetur, orthodhoksë që prehen me shpresë këtu e kudo.

Lutemi edhe për ata që sjellin pemë dhe bëjnë punë të mira në këtë kishë të shenjtë dhe të gjithënderuar, që mundohen, që psalin dhe për popullin që qëndron rrotull, dhe pret prej Teje mëshirën e madhe dhe të pasur.

**Prifti:**

Se ti je Perëndi mëshirues dhe njeridashës dhe ty ta drejtojmë lavdinë, Atit e Birit edhe Shpirtit të Shenjtë, tani e përherë e në jetë të jetëve. Amin.

**Dhiaku:** Le ta plotësojmë lutjen tonë të mëngjesit ndaj Zotit. Përkrahna, shpëtona, mëshirona dhe ruajna, o Perëndi, me hirin tënd.  
Tërë ditën të përsosur, të shenjtë, me paqe dhe të pamëkatshme, le t'ia lypim Zotit.  
Engjëll paqeje, udhëheqës besnik, ruajtës të shpirtave dhe të trupave tanë, le t'i lypim Zotit.  
Ndjesë dhe falje të mëkateve dhe të fajeve tona, le t'i lypim Zotit.  
Të mirat dhe të dobishmet për shpirtat tanë dhe paqe për botën, le t'i lypim Zotit.  
Që të kalojmë në paqe dhe në pendim jetën që na mbetet, le t'i lypim Zotit.  
Mbarim të krishterë të jetës sonë, pa dhembje, faqebardhë, me paqe, dhe mbrojtje të mirë përpara gjykatores së trembshme të Krishtit, le të lypim.  
Të Tërëshenjtën, të pacënuarën, të përmbibekuarën, të lavdëruarën Zonjën tonë Hyjlindësen dhe gjithmonë Virgjërën Mari, bashkë me gjithë shenjtoret, duke e kujtuar, — veten tonë dhe njeri-tjetrin dhe gjithë jetën tonë, Krishtit Perëndisë, le t'ia parashtojme.

**Prifti:** Se ti je Perëndi mëshire, dhembshurimesh dhe njeridashjeje dhe Ty ta drejtojmë lavdinë, Atit e Birit edhe Shpirtit të Shenjtë, tani e përherë e në jetë të jetëve. Amin.

**Prifti:** Paqe në të gjithë.

**Dhiaku:** Kryet tanë le t'ia ulim Zotit.

*Prifti lutet pa zë duke thënë këtë uratë:*

**Prifti:** O Zot i shenjtë, që banon në të lartat e mbikqyr ato që janë poshtë, dhe që me syrin tënd gjithëshikues vështron tërë krijesën, para teje e ulëm qafën e shpirtit dhe të trupit, dhe të lutemi, o shenjt i të shenjtëve; zgjat dorën tënde të padukshme prej banesës sate të shenjtë dhe bekona të gjithë; dhe në qoftë se bëmë ndonjë mëkat

me dashje ose padashje, ndjena si Perëndi i mirë dhe njeridashës, duke na dhuruar të mirat e tua të dheshme dhe qiellore.

Se ti e ke në dorë të na mëshirosh dhe të na shpëtosh, o Krisht Perëndia ynë dhe Ty ta drejtojmë lavdinë, Atit e Birit edhe Shpirtit të Shenjtë, tani e përherë e në jetë të jetëve. Amin.

**Dhiaku:** Urtësi. Beko, o Zot.

**Prifti:** Krishti Perëndia ynë që është i bekuar, tani e përherë e në jetë të jetëve. Amin.

Lavdi më Ty, o Perëndia ynë, lavdi më Ty.

Krishti Perëndia ynë i vërtetë (*në qoftë se është e dielë shto*: që u ngjall prej së vdekurish), me ndërmjetimet e Nënës së Tij të pacënuar dhe krejt të papërlyer dhe të shenjtë, të Etërve tanë oshënarë dhe hyjprurës, të hyjprindërve të shenjtë dhe të drejtë Joakim dhe Anës dhe të gjithë shenjtorëve të tij, na mëshiroftë dhe na shpëtoftë si i mirë dhe njeridashës.

Me uratat e Etërve tanë të shenjtë, o Zot Iisu Krisht, mëshirona dhe shpëtona. Amin.

